



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.05.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Raportim i Ministres së Drejtësisë mbi mënyrën e zbatimit nga organi i Prokurorisë të rekomandimeve prioritare të dhëna nga Këshilli i Ministrave për vitin 2018

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Alban Zeneli, Andi Përmeti, Korab Lita, Aurora Mara, Elda Hoti, Adriatika Alimadhi, Elena Xhina, Xhemal Qefalia dhe Edlira Bode.

Mungojnë:

Fatmir Xhafaj, Bashkim Fino, Damian Gjikhuri, Edmond Leka, Alket Hyseni dhe Tom Doshi.

Të ftuar :

Znj. Etilda Gjonaj – Ministria

Znj. Edlira Bako - Drejtor Rregullatore për Çështjet e Drejtësisë

Z. Besmir Beja - Këshilltar i Ministrit

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme.

Sot kemi një çështje në rendin e ditës.

Në funksion të kontrollit parlamentar, Komisioni i Ligjeve ka të ftuar në seancë dëgjimore ministren e Drejtësisë, e cila do të raportojë para komisionit për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve prioritare nga organi i prokurorisë, të dhëna nga Këshilli i Ministrave për vitin 2018.

Prezent sot në komision kemi zonjën Etilda Gjonaj, ministre e Drejtësisë.

Mirë se keni ardhur në Komisionin e Ligjeve!

Ministrja shoqërohet edhe nga pjesëtarë të stafit të Ministrisë së Drejtësisë.

Relacionin që ministrja do të relatojë sot në komision, kolegët e kanë mbi tryezë, natyrisht do t'ju ketë ardhur edhe nëpërmjet postës elektronike.

Fjala për zonjën Gjonaj, për të bërë një prezantim të shkurtër të rekomandimeve të Këshillit të Ministrave për organin e prokurorisë dhe më pas do të kalojmë në pyetje dhe diskutime.

Etilda Gjonaj – I nderuar kryetar i komisionit,

Të nderuar anëtarë,

Faleminderit për ftesën, lidhur me një raportim shumë të rëndësishëm, i cili vjen në kuadër të detyrimeve ligjore që ka ministri i Drejtësisë, njëkohësisht Këshilli i Ministrave, nëpërmjet ministrit të Drejtësisë për të raportuar, por në bazë edhe të legjislacionit të vjetër, por njëkohësisht edhe ligjit të ri, është ruajtur pikërisht kompetenca e Këshillit të Ministrave, nëpërmjet ministrit të

Drejtësisë për të ndjekur në mënyrë të vazhdueshme veprimtarinë dhe zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave nga Prokurori i Përgjithshëm.

Është pikërisht ligji nr. 97/2016 “Për organin e prokurorisë”, i cili parashikon në nenin 103 të tij se Këshilli i Ministrave, nëpërmjet ministrit të Drejtësisë ndjek në vazhdimësi mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të dhëna prej tij. Në kuadër të këtij detyrimi ligjor, ministri i Drejtësisë në mënyrë të vazhdueshme periodike, merr informacion nga Prokurori i Përgjithshëm lidhur me zbatimin e rekomandimeve të vitit.

Jemi në fazën që ministri i Drejtësisë ka përgatitur raportin për zbatimin e rekomandimeve të vitit 2018 nga Prokurori i Përgjithshëm.

Paralelisht, ministri i Drejtësisë i ka bërë prezent edhe Prokurorit të Përgjithshëm para disa ditësh rekomandimet e vitit 2019 të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave si rekomandime prioritare në luftën kundër kriminalitetit.

Rekomandimet për vitin 2018 janë përcjellë dhe u janë bërë të njohura drejtuesve të prokurorisë dhe të gjitha shkallëve në një mbledhje të përbashkët. Rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave për organin e prokurorisë për vitin 2018 janë mbështetur në analizën e dokumenteve strategjike qeveritare, raportet e organizmave ndërkombëtarë, kontributet e paraqitura nga ministritë e linjës, siç është: Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mjedisit, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave, por njëkohësisht edhe nga statistikatat zyrtare të organit të prokurorisë.

Këshilli i Ministrave në mbledhjen e datës 10.05. 2019 ka miratuar rekomandimet prioritare edhe për vitin 2019, të cilat synojnë përmirësimin e efektivitetit të masave që duhet të ndërmerren nga organi i prokurorisë në luftën kundër kriminalitetit.

Viti 2018 ishte një vit shumë i rëndësishëm dhe vit kyç për zbatimin e reformës në drejtësi. Prokuroria e Përgjithshme ka luajtur një rol kyç, veçanërisht në procesin e vlerësimit profesional të të gjithë kandidatëve që iu nënshtruan me prioritet procesit të vetingut dhe në zbatimin transparent të procedurave për thirrjen dy herë të mbledhjes së përgjithshme të prokurorëve, nga e cila u zgjodhën anëtarët prokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Reforma në drejtësi dhe institucionet e reja të sistemit të drejtësisë, veçanërisht ngritja e SPAK-ut dhe gjykatave të posaçme, do të garantojnë ndëshkimin e zyrtarëve të lartë të përfshirë në çështje korrupsioni dhe ky do të jetë një hap shumë i rëndësishëm që do të ndihmojë në rifitim

e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë dhe do të shënojë një gur themeli në luftën kundër korrupsionit.

Me ngritjen e këtyre organeve Prokurori i Përgjithshëm do të jetë në gjendje për të përmbushur më së miri të gjitha rekomandimet e dhëna nga Këshilli i Ministrave për luftën kundër kriminalitetit, veçanërisht ato rekomandime që lidhen edhe me prioritetin kryesor të qeverisë shqiptare, që është lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Qeveria shqiptare ka dhënë dhe do të vijojë të japë gjithë mbështetjen e saj të nevojshme infrastrukturore dhe financiare për funksionimin optimal të institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë, si dhe do vazhdojë t'i japë mbështetje maksimale organeve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, si një garanci për ndërtimin e një sistemi drejtësie ashtu siç e meritojnë qytetarët shqiptarë, të drejtë, të pavarur dhe të denjë për një shtet europian.

Lufta kundër kriminalitetit, ashtu siç jua përmenda, nuk është thjeshtë prioriteti i vetëm i qeverisë shqiptare, por i të gjitha institucioneve të sistemit të drejtësisë, duke përmbushur kështu jo vetëm një rekomandim në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Europian, por edhe të misionit për shtetformimin dhe për t'u ofruar qytetarëve shqiptarë sigurinë e jetës, si dhe për të siguruar njëkohësisht rendin publik dhe atë kushtetues.

Rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave për Prokurorin e Përgjithshëm për vitin 2018 kanë qenë fokusuar në këto drejtime: garantimi i pavarësisë së prokurorit, lufta kundër korrupsionit, lufta kundër krimit të organizuar, të drejtat e njeriut, si dhe bashkëpunimi ndërinstitutional dhe ndërkombëtar.

Po ndalem shkurtimisht te disa nga gjetjet kryesore të këtij raporti, sepse pa dyshim raporti më i detajuar i ka ardhur Komisionit të Ligjeve, dhe mbetem e hapur për pyetjet tuaja apo për çështje, të cilat kërkojnë një vëmendje më tej nga ajo çfarë unë do të referoj.

Duke pasur në konsideratë rolin e rëndësishëm që luante Prokuroria e Përgjithshme për garantimin e pavarësisë së prokurorit gjatë periudhës tranzitore deri në ngritjen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2018, ndër të tjera Këshilli i Ministrave kishte rekomanduar për vitin 2018 angazhimin maksimal të Prokurorisë së Përgjithshme me qëllim përsheptimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të prokurorëve, forcimin e kapaciteteve të Prokurorisë së Përgjithshme për realizimin sa më me efektivitet të procesit të dekriminalizimit, si dhe marrjen e masave për forcimin e rolit të prokurorit në hetimin paraprak në funksion të shtimit të rasteve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë. Në zbatim të këtyre rekomandimeve Prokuroria e

Përgjithshme ka dorëzuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimeve gjithsej 83 raporte të vlerësimit profesional të subjekteve prokuror apo drejtues, si dhe ka hedhur shortin për përzgjedhjen e çështjeve për vlerësimin profesional për 118 prokurorë, duke e mbajtur në konsideratë që ky proces është në vazhdim.

Deri më 28 dhjetor 2018 Prokuroria e Përgjithshme kishte përfunduar shortin për prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme, drejtuesit e prokurorive të apelit dhe të shkallëve të para, prokurorët e Prokurorisë së Krimeve të Rënda, të apeleve Tiranë, Durrës, Shkodër, Gjirokastrë dhe Korçë, si dhe të prokurorët e prokurorive të shkallëve të para Sarandë, Gjirokastrë, Përmet, Kavajë, Kurbin, Tropojë, Pukë, Kukës, Dibër, Mat, si dhe pjesërisht shortin për prokurorët e shkallëve të para Tiranë, Shkodër, Krujë dhe Vlorë.

Gjatë vitit 2018 Prokuroria e Përgjithshme ka administruar 180 raste për verifikim të thelluar, nga të cilat për 147 prej tyre procesi ka përfunduar. Nga 147 raste apo vendime për 31 subjekte materialet referuese u janë dërguar për kompetencë prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, pasi ka rezultuar se këta shtetas kanë deklaruar të dhëna të pavërteta, të rreme në formular, duke konsumuar veprën penale të falsifikimit të vulave, të stampave dhe të formularëve, të parashikuara nga neni 190 i Kodit Penal.

Shqetësim mbetet numri i çështjeve të filluara kryesisht nga prokurorët. Nga 46 892, që është numri i përgjithshëm i çështjeve penale të referuara dhe të kallëzuara për vitin 2018, vetëm 109 janë çështje që janë filluar kryesisht nga prokuroria. Numri i çështjeve penale të filluara nuk ka pasur rritje, por në krahasim me vitin 2017 ka një rënie dhe e njëjta gjë është edhe për veprat penale kundër korrupsionit, ku çështjet e filluara kryesisht nga prokuroria janë 20% e numrit total të atyre që janë filluar kryesisht për vitin 2018, por në krahasim me vitin 2017 ka një ulje prej 24 çështjesh.

Një çështje tjetër është edhe numri i ulët i dosjeve për të cilat është kërkuar gjykim i drejtpërdrejtë. Organi i prokurorisë për vitin 2017 ka dërguar për gjykim 11 492 çështje, por vetëm për 708 prej tyre ka kërkuar që të gjykohen me procedurë gjykimi të drejtpërdrejtë.

Këto janë ato që doja t'ju thosha sa i përket rekomandimit apo drejtimit të parë për çështjen e garantimit të pavarësisë së prokurorit.

Sa i përket drejtimit të dytë, luftës kundër korrupsionit, ashtu siç jeni në dijeni të gjithë, ashtu siç ne kemi referuar në mënyrë të vazhdueshme një nga prioritete kryesore mbi bazën e së cilës janë dhënë edhe rekomandimet përkatëse është lufta kundër korrupsionit, duke vazhduar të

mbetet një sfidë edhe për vitin 2019 si në masat parandaluese, por edhe në masat ndëshkuese për hetimin, gjykimin dhe dërgimin para përgjegjësisë të të gjithë atyre që janë përfshirë në çështje korruptive. Jo vetëm si ministre e Drejtësisë, por edhe me një cilësi dhe përgjegjësi të shtuar si koordinatorë kombëtarë antikorrupsion, një përgjegjësi në nivel kombëtar, një sërë rekomandimesh drejtuar organit të prokurorisë për masat që duhet të merren për hetimin e veprave penale të korrupsionit.

Nga të dhënat për vitin 2018 rezulton se ka një ulje të numrit të personave nën hetim pavarësisht rritjes së numrit të çështjeve të korrupsionit në krahasim me vitin 2017, duke shënuar kështu një aspekt pozitiv, por për vitin 2018 janë regjistruar 1721 procedime penale për vepra penale në fushën e korrupsionit, me një numër total prej 372 personash nën hetim dhe janë marrë të pandehur 300 persona. Ajo çfarë rezulton është se janë dëgjuar për gjykim 148 procedime penale me 285 të pandehur, për këtë vit ka përfunduar gjykimi për 112 çështje penale në një numër prej 207 të pandehurish, nga të cilët janë dënuar 165 persona.

Nga këto të dhëna rezulton rritje e çështjeve të regjistruara krahasuar me vitin 2017 me 143 çështje penale më tepër, por ulje e çështjeve të dërguara për gjykim me 112 çështje më pak si edhe ulje e numrit të personave të pandehur. Rezulton se ka rënie të çështjeve të përfunduara në gjykim me 146 çështje më pak si edhe rënie të numrit të të pandehurve me 75 persona më pak në krahasim me vitin 2017. Ajo që përbën shqetësim është pikërisht dërgimi i një numri të vogël të procedimeve penale për gjykim që është rreth 8,6 % e numrit total të çështjeve të regjistruara dhe në krahasim me vitin 2017 shënon një rënie të numrit të çështjeve me 112 çështje më pak.

Gjithashtu, një çështje tjetër që lidhet me masat e dënimit të kërkuara nga prokuroria për këto vepra penale gjatë vitit 2018 për veprat penale të fushës së korrupsionit në përfundim të gjykimit kërkesa e prokurorisë ka qenë për 8 të pandehur dënim me gjobë dhe 182 dënime me burg. Pra, shikojmë që ka një ashpërsim të kërkesave nga ana e prokurorisë lidhur me dënimin për veprat penale në të cilat të pandehurit janë për vepra penale kundër korrupsionit. Duke mbajtur në konsideratë shifrat e ulta të fillimit të veprave penale kryesisht të filluara për vitin 2019 i është rekomanduar njëkohësisht në vazhdimësi Prokurorit të Përgjithshëm zbatimi efektiv i ligjit. Gjithashtu nëpërmjet rritjes së numrit të hetimeve proaktive, duke përfshirë këtu çështjet e filluara kryesisht, por edhe njëkohësisht shtimit të numrit të rasteve të përdorimit të metodave speciale të hetimit në drejtim të luftës kundër korrupsionit në vazhdimësi, i është rekomanduar një ashpërsim

i politikave penale veçanërisht në rastet e korrupsionit të zyrtarëve të nivelit të lartë. Kjo në vlerësim të këtij prioriteti si më i rëndësishëm në luftën kundër kriminalitetit.

Nga të dhënat e vitit 2018 në krahasim me vitin 2017 në raportin që Ministria e Drejtësisë ka përgatitur vihet re një rënie e numrit të çështjeve të regjistruara për veprat penale të pastrimit të parave. Pra, vijon të mbetet një numër i vogël hetimesh pasurore të kryera nga organi i prokurorisë që lidhen me veprën penale të korrupsionit, ndërkohë që për vitin 2018 është rekomanduar në mënyrë të vazhdueshme rritje e hetimeve proaktive, shtimi i hetimeve sistematike pasurore dhe rritja e numrit të cilësisë së hetimeve sidomos të rasteve të zyrtarëve publikë.

Sa u përket rekomandimeve, Prokurorit të Përgjithshëm i janë adresuar për vitin 2019 rekomandime që kanë të bëjnë me luftën kundër krimit të organizuar, i cili është një ndër kryefjalët e luftës kundër kriminalitetit, një nga prioritetet kyçe të qeverisë dhe pikë së pari, një detyrim i të gjithë institucioneve të sistemit të drejtësisë, i qeverisë, i politikave qeveritare ndaj qytetarëve shqiptarë, por njëkohësisht edhe për të plotësuar një nga rekomandimet kryesore të BE-së.

Forcimi i bashkëpunimit me organizatat rajonale dhe ndërkombëtare në drejtim të luftës kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe terrorizmit është një tjetër drejtim në të cilin janë fokusuar rekomandimet e qeverisë shqiptare. Në vitin që lamë pas ka një rezultat shumë pozitiv që është nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me “Eurojust” dhe ratifikimi nga Kuvendi i Shqipërisë duke hedhur një hap pozitiv të zhvilluar në një kohë shumë të shpejtë, i cili krijon mundësinë e një shkëmbimi të sigurt dhe eficient të informacionit gjyqësor, shkëmbimit të provave me organet dhe agjencitë ligjzbatuese ndërkombëtare në funksion të rritjes së efikasitetit të luftës kundër krimit të organizuar dhe pastrimit të parave. Kjo marrëveshje ka për objekt zgjerimin dhe bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe “Eurojust” në luftën kundër krimeve të rënda veçanërisht kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit duke lehtësuar kështu edhe bashkërendimin e hetimeve dhe ndjekjeve penale që mbulojnë territorin e Republikës së Shqipërisë ose një ose më shumë shteteve anëtare të Bashkimit Europian nëpërmjet krijimit dhe financimit të ekipeve të përbashkëta hetimore. Me caktimin e prokurorit ndërlidhës në Hagë do të bëhet i mundur krijimi i një mekanizmi shumë efikas në luftën e krimit të organizuar me karakter transnacional. I kemi rekomanduar edhe për vitin 2019...

(Ndërprerje incizimi)

Ulsi Manja- Zonja Ministre, rregullat e reja duan pak kohë për t’u adaptuar.

Etilda Gjonaj – I është kërkuar dhe rekomanduar Prokurorisë së Përgjithshme, meqenëse kjo marrëveshje është ratifikuar tashmë nga Kuvendi, të marrë të gjitha masat për këtë pjesë të parë të vitit 2019 për plotësimin dhe sigurimin e kushteve të nevojshme teknike dhe organizative për sigurinë e të dhënave personale, për krijimin e regjistrit për komunikimet me Eurojust-in, me qëllim finalizimin këtij procesi shumë të rëndësishëm dhe të vlerësuar pozitivisht edhe nga BE-ja.

Kur krahasojmë shifrat me vitin 2017, na rezulton se shënohet një rritje e ndjeshme e numrit të çështjeve të regjistruara për krimin e organizuar prej rreth 2,5 herë, si dhe ka një rritje të numrit të personave nën hetim me rreth 2 herë më shumë. Gjithsesi, është adresuar një shqetësim i Prokurorisë së Përgjithshme edhe për vitin 2019, në vazhden e rezultateve dhe raportit të vitit 2018, lidhur me numrin e çështjeve të dërguara për gjykim dhe numrit të personave të marrë si të pandehur, i cili ka pasur një rënie krahasuar me vitin 2017. Për këtë arsye, është rekomanduar se nevojitet shpejtësi në procedurat hetimore dhe dërgimin e dosjeve në gjykatë, si dhe është konsideruar tepër e dobishme rritja e numrit të hetimeve proaktive, me qëllim identifikimin, dërgimin në gjykatë të drejtuesve të organizatave kriminale, që lidhen me veprat penale të krimit të organizuar.

Si një shqetësim i të gjithë partnerëve ndërkombëtarë, por edhe i autoriteteve qendrore të huaja, këtu kam parasysh ministrinë e drejtësisë të vendeve të ndryshme europiane, me rëndësi është zhvillimi i hetimeve financiare cilësore lidhur me rastet e organizatave apo grupeve të strukturuar kriminale, me fokus rritjen e numrit të aseteve të sekuestruara që në fazën fillestare të hetimit dhe rritjen e numrit të aseteve të konfiskuara.

Një aspekt, i cili ka çaluar gjatë vitit 2018, është edhe mbajtja e të dhënave në një *database* unik, për t'i raportuar në mënyrë periodike të dhënat që lidhen pikërisht me veprat penale apo me hetimet, me numrin e çështjeve për krimin e organizuar dhe me rastet kur janë sekuestruar apo konfiskuar nga asetet e lidhura me këto vepra penale.

Kjo do të ndihmoje edhe Ministrinë e Drejtësisë për të raportuar në mënyrë korrekte në strukturat e Komisionit European, lidhur edhe me rekomandimet apo prioritetet që BE-ja i ka lënë Shqipërisë për sa i përket krimit të organizuar.

Nga të dhënat statistikore, ka rezultuar se për veprat penale të trafikimit për vitin 2018 ka një rënie e lehtë të numrit të çështjeve të regjistruara, me 6 çështje më pak. Gjithsesi, në lidhje me

çështjet e dërguara, vihet re se ka një rritje të lehtë të dosjeve që kanë shkuar për gjykim, krahasuar me vitin 2017.

Lufta kundër kultivimit të bimëve narkotike, trafikut të drogave dhe lufta kundër krimit të organizuar janë drejtimet ku është fokusuar dhe suksesi i institucioneve dhe strukturave të ngarkuara për parandalimin dhe goditjen e fenomenit të kultivimit dhe përdorimit të kanabisit, të cilat maten pikërisht me identifikimin, me zbulimin, me ndalimin dhe vënien para drejtësisë të financuesve të grupeve dhe rrjeteve kriminale.

Dobësimi i financave të rrjeteve kriminale, krimit të organizuar dhe terrorizmit, nëpërmjet sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurimeve të të ardhurave të përfituara nga aktiviteti kriminal, është po ashtu një drejtim tjetër kryesor, ku është fokusuar lufta kundër krimit të organizuar. Kjo ka gjetur vend, si një nga rekomandimet e vitit 2018, edhe në këtë raport që po paraqesim sot, njëkohësisht edhe në vazhden e rekomandimeve të vitit 2019 për të adresuar të njëjtën problematikë.

Nga të dhënat e vitit 2018, krahasuar me vitin 2017, konstatohet se ka një rënie të numrit të çështjeve të hetuara për këto vepra penale. Më e dukshme është ulja e numrit të procedimeve dhe të pandehurve që janë dërguar për gjykim nga organi i prokurorisë.

Lidhur me veprat penale në fushën e terrorizmit, nga të dhënat statistikore rezulton se janë regjistruar në total 4 çështje për vitin 2018. Për këto çështje të regjistruara nuk ka persona nën hetim dhe as persona të marrë në cilësinë e të pandehurit. Gjithashtu, nuk rezulton asnjë çështje e dërguar për gjykim gjatë vitit 2018.

Lidhur me veprat penale për nxitjen e urrejtjes dhe pjesëmarrjes në konflikte të armatosura, për vitin 2018 janë regjistruar 5 çështje penale dhe 2 persona janë marrë si të pandehur, por nuk ka rezultuar asnjë çështje e dërguar për gjykim për këtë kategori veprash penale. Në krahasim me vitin 2017, për vitin 2018 vihet re një rënie e lehtë për çështjet që kanë të bëjnë me terrorizmin, nxitjen e urrejtjes dhe pjesëmarrjen në konfliktet e armatosura. Gjithsesi, krahasuar me vitin 2017, për vitin 2018 nuk ka asnjë çështje të dërguar për gjykim.

Një drejtimi tjetër shumë i rëndësishëm për vitin 2018, njëkohësisht edhe në vazhden e rekomandimeve për vitin 2019, është respektimi i të drejtave të njeriut. Pa dyshim, ky është një nga prioritet kryesorë të qeverisë shqiptare, me fokus të veçantë grupet vulnerabël të shoqërisë. Për këtë arsye edhe për vitin 2019 ka një sërë rekomandimesh lidhur me rritjen e kërkesave për dënimet alternative për autorë me rrezikshmëri të ulët shoqërore, për zbatimin e Kodit Penal për

të Miturit për trajtimin e të miturve me organet drejtësisë në zbatim të legjislacionit, me qëllim që të lehtësohen masat e sigurisë, njëkohësisht edhe dënimet për këtë kategori.

Nga ana tjetër, është rekomanduar ashpërsimi i masës së sigurimit dhe masës së dënimit për veprat penale me natyrë gjinore dhe diskriminuese, si dhe për rastet e keqtrajtimit, abuzimit, shfrytëzimit dhe trafikimit të fëmijëve.

Për vitin 2018, për veprën penale dhunë në familje janë regjistruar 1209 çështje ose 2,8% të të gjitha çështjeve penale të regjistruara. Për këto çështje janë marrë në cilësinë e të pandehurit 842 persona, por rezulton që nga numri total i të gjitha çështjeve, vetëm 8,5% janë dërguar për gjykim.

Lidhur me politikën e dënimit të ndjekur gjatë gjyqimit, në çështjet e dërguara për gjykim nga prokuroria për dhunën në familje, vetëm për 12 të pandehur, nga 842 që është numri total, është kërkuar dënimi maksimal i parashikuar nga paragrafi përkatës i dispozitës. Nga këto të dhënë rezulton që ka një rënie të çështjeve nën hetim për veprën penale dhuna në familje. E krahasuar me vitin 2017, ka një rritje me 26 persona më tepër që janë nën hetim dhe ka një rënie prej 110 personash më pak që janë marrë si të pandehur.

Në vitin 2018 ka një rënie prej 176 çështjesh të gjykuara me 191 të pandehur më pak.

Në lidhje me dënimin e kërkuar nga prokurori, rezulton një rritje e rasteve, për të cilët është kërkuar dënim maksimal krahasuar me vitin 2017.

Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ai ndërkombëtar ndërmjet agjencive ligjzbatuese, ndikon drejtpërdrejt në rritjen e efektivitetit të hetimeve ndaj grupeve të strukturuar kriminale dhe është premisë bazë për suksesin e veprimtarisë së organit të prokurorisë lidhur me hetimin dhe goditjen e kriminalitetit. Ne vlerësojmë se bashkëpunimi i organeve të hetimit, pra jo vetëm me oficerët e Policisë Gjyqësore, por edhe përfshirja e tyre në hetim me qëllim efektivitetin e burimeve njerëzore sjell jo vetëm hetime të plota dhe të gjithanshme, por edhe finalizim me sukses të çështjeve të regjistruara, duke shmangur referimet fiktive dhe hetimet të dështuara me pasojë vënien para përgjegjësisë penale të elementëve të rrezikshëm kriminalë. Përmend këtu edhe bashkëpunimin me Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve, me qëllim evidentimin e saktë të veprave penale dhe vënien përpara përgjegjësisë penale të autorëve dhe zhvillimin e një hetimi efikas. Bashkëpunimi ndërkombëtarë, shkëmbimi i informacionit dhe i përvojës, organizimi i operacioneve të përbashkëta dhe mbështetja logjistike e financiare nga

partnerët ndërkombëtarë është po aq e rëndësishëm në suksesin e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Gjatë vitit 2018 janë shënuar një sërë bashkëpunimesh ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, se mbaroi ministrja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Gjonaj, mund ta përmbyllni këtë prioritet të fundit që ka të bëjë me bashkëpunimin institucional.

Etilda Gjonaj – Kjo që dua të them është shumë e rëndësishme jo vetëm për Prokurorinë e Përgjithshme, por për të gjithë qeverinë, duke përfshirë edhe Kuvendin në këtë rast, për shkak se janë krijuar për herë të parë një sërë grupesh hetimore (kur them për herë të parë, nuk është se nuk kanë ekzistuar më parë), për bashkëpunim dhe procedime, të cilat kanë rezultuar me sukses, pavarësisht vështirësisë që kanë pasur për sa i përket kompleksitetit të çështjeve dhe të veprave penale me karakter jo vetëm brenda territorit, por edhe me shtete të tjera.

Gjithsesi, bashkëpunime të mëtejshme do të shënohen edhe me vende të tjera, si: Holanda, Gjermania dhe Franca, ku pritet të krijohen grupe hetimore të përbashkëta për vepra penale, për të cilat duhet një bashkëpunim mes dy shteteve.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Ministre, për këtë prezantim të detajuar dhe shterues të prioritetëve të qeverisë në lidhje me luftën kundër kriminalitetit!

Fjalën ia kaloj relatores, zonjës Bushka, për të bërë një prezantim të shkurtër në këndvështrimin se si e shikon Komisioni i Ligjeve këtë problematikë. Më pas kolegët janë të hapur për pyetje.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Ministre, për raportin!

Zonja ministre prezantoi informacionin e raportit, i cili u bë i qartë për kolegët e komisionit, prandaj unë nuk dua ta përsëris, por për efekt të opinionit publik më duhet të sqaroj se kjo dëgjese e ministres është në kuadër të ndryshimeve ligjore në lidhje me reformën që u bë në sistemin e drejtësisë.

Një herë në vit Këshilli i Ministrave, që përfaqësohet nga Ministria e Drejtësisë, paraqet rekomandimet kryesore që janë prioritetet e vendit, në mënyrë që të ndiqen nga organi i prokurorisë në ushtrimin e detyrës.

Një herë në vit, Prokurori i Përgjithshëm, përveç kompetencave të tjera që ka për të ushtruar dhe detyrimit që ka për të raportuar në Komisionin e Ligjeve, pjesë e pyetjeve dhe e dëgjësive është edhe përmbushja e detyrimeve apo rekomandimeve që parashikohen në materialin e miratuar nga Këshilli i Ministrave, i cili ia paraqet Prokurorisë së Përgjithshme për punën e vitit përkatës. Në këtë kuadër ne duhet të dëgjojmë ministrin e Drejtësisë se si janë plotësuar rekomandimet e vitit të kaluar dhe se si ka qenë ecuria në mënyrë që, kur të bëhet raportimi i Prokurorit të Përgjithshëm në komision, të kemi një panoramë të qartë të të gjitha çështjeve që i shërbejnë interesit publik dhe për vitin e kaluar kanë qenë edhe në prioritetet e qeverisë. Në prioritetet e qeverisë për vitin 2018, vit për të cilin po relatohet edhe ministrja sot, ka qenë garantimi i pavarësisë së prokurorit, lufta kundër korrupsionit, lufta kundër krimit të organizuar, të drejtat e njeriut, bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ndërkombëtar.

Unë nuk dua të zgjatem në përfundimet e raportit që paraqiti ministrja, por kam 2-3 pyetje për ministren, e cila mund t'i mbajë shënim së bashku me pyetjet e kolegëve të tjerë.

E para, ka të bëjë me një fakt të rëndësishëm, që e konstatojmë jo vetëm nga raporti i ministres, por edhe nga diskutimet që kanë bërë anëtarët e nderuar të këtij komisioni për plotësimin me dispozita ligjore të dy ligjeve të reformës në drejtësi, të cilat janë prekur nga vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Njëri prej tyre ka shumë rëndësi, sepse ka të bëjë me përcaktimin e saktë të masave disiplinore për prokurorët dhe magjistratët gjyqtarë dhe për sa kohë flasim për masa disiplinore kemi të bëjmë me një lloj kontrolli që sot, në sistemin ri të drejtësisë që kemi krijuar në saj të reformës për drejtësi, do të ushtrohet nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i cili nuk është krijuar ende, por deri sa të krijohet, sipas ligjeve të reformës, ka dispozita transitorie, të cilat i japin kompetencë të përkohshme Prokurorit të Përgjithshëm të përkohshëm apo organeve të tjera në institutet e tjera të drejtësisë për të kryer inspektimin. Pse është i rëndësishëm inspektimi në ecurinë e punës? Sepse ka të bëjë me përgjegjësinë gjatë ushtrimit të detyrës të atyre që shërbejnë në sistemin e drejtësisë. Meqenëse sot po flasim për organin e Prokurorisë së Përgjithshme, duke e lidhur me rekomandimet që ka dhënë qeveria për vitin 2018, një prej tyre ka qenë pavarësia e institucionit, rritja profesionale, si dhe mbajtja e përgjegjshme e atyre që punojnë në organin e prokurorisë. Kompetencën për të kryer veprime që kanë të bëjnë me disiplinën, me sjelljen e

prokurorëve në punë gjatë kësaj kohe e ka pasur Prokurori i Përgjithshëm, por në mungesë të dispozitave ligjore, të cilat janë të qarta për masat disiplinore apo procedurat përkatëse, sipas raportit që paraqiti ministria e Drejtësisë, shikojmë që kemi një pengim ose një ulje të numrit të këtyre rasteve, të cilat janë të rëndësishme, sepse asnjë organ, pavarësisht se ne prezumojmë që organet kanë integritetin dhe profesionalizmin e tyre, pa një mekanizëm kontrolli nuk mund të themi se përgjegjshmëria është në nivelin maksimal. Në këtë pikë doja të pyesja zonjën ministre: a ka qenë problem vetëm mungesa e dispozitave ligjore për sa i takon kontrollit të disiplinës, apo ka shkaqe të tjera?

E dyta, në raportin tuaj relatoni se është kryer e gjithë puna për të vënë në funksion një sistem të menaxhimit të çështjeve elektronike, por nuk janë reflektuar në këtë sistem ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale. Cilat janë konkretisht dhe sa ndikojnë në pavarësinë e institucionit?

E treta, në saj të reformës në drejtësi, organi i prokurorisë nuk është më një organ i centralizuar, por tashmë fuqinë e nisjes së hetimit, kompetencën e hetimit ia ka lënë prokurorit të çështjes. Pra, nuk është më drejtuesi i prokurorisë, qoftë në nivelin qendror apo vendor ai që ka rol në hetimet proaktive për një çështje. Ndërkohë, nga raporti, të paktën, për çështjet e korrupsionit, hetimet për konfiskimin e pasurive nga krimi i organizuar apo hetimet pasurore, vë re se thoni që ka një ulje të hetimeve. Domethënë, në disa raste ka ngritje, por ka ulje të numrit të atyre që janë marrë të pandehur. Cila është arsyeja që keni nxjerrë nga statistikave e analizuara? Në këtë moment kemi më pak kallëzime apo referime, qoftë nga qytetarët, qoftë nga organet e shtetit, apo ka të bëjë me çështjet e organizimit të punës, më çështje logjistike, me stafe apo mungesë trajnimi?

E fundit, trajnimet e prokurorëve dhe të Oficerëve të Policisë Gjyqësore për çështjet që kanë sensitivitet për sa u takon të drejtave të njeriut për grupe të veçanta, si të miturit, që ka organizuar prokuroria, janë në numër më të lartë apo më të ulët se në vitin 2017?

Këto janë pyetjet që kam.

Gjithashtu, dua të falënderoj ministren e Drejtësisë për raportin shterues që ka paraqitur!

Për sa i takon pjesës rekomanduese të vitit 2019, për kolegët është kjo, kemi një pjesë të tyre në raportin që ka paraqitur Ministria e Drejtësisë. Pra, jo vetëm çfarë është kërkuar si rekomandim nga qeveria në 2018-n dhe sa janë përmbushur këto nga Prokuroria e Përgjithshme, por në raportin që keni përpara ka edhe disa rekomandime për vitin 2019, që i bën qeveria, e përfaqësuar nga Ministria e Drejtësisë. Kjo është për informacionin tuaj, nëse do të keni ndonjë pyetje, që mund t'ju duket e përshtatshme në këtë moment.

Faleminderit, zoti kryetar!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bushka!

Zonja Ministre, do t'u përgjigjeni pyetjeve të secilit koleg veçmas apo do t'i dëgjojmë të gjitha pyetjet e kolegëve? Se mund të kenë natyrë, problematika të përbashkëta dhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Veç e veç? Dakord.

Andi Përmeti – Veç e veç, se pastaj humbet kuptimin dhe...

Ulsi Manja – Atëherë, përgjigjuni pyetjes së koleges Bushka dhe... Ka disa kolegë që...

Etilda Gjonaj – Për sa i përket shqetësimit apo pyetjes që referoi zonja Bushka për hetimet disiplinore të iniciuara nga Prokuroria e Përgjithshme, rezulton se për vitin 2018 janë vetëm 2 hetime disiplinore. Ministria e Drejtësisë vlerëson se vakumi ligjor ka krijuar një problematikë, por, nga ana tjetër, Prokurori i Përgjithshëm, pavarësisht këtij vakumi të krijuar nga dispozitat e shfuqizuara tashmë nga Gjykata Kushtetuese, është i vetmi mekanizëm inspektues deri sa të ngrihet Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Pavarësisht kësaj dhe të gjitha mëkateve që kemi ne për mosmiratimin dhe mosarritjen e shumicës së cilësuar për miratimin e atyre ndryshimeve, që, në fakt, janë shumë të nevojshme dhe më vjen mirë që është iniciuar përsëri lëvizja dhe rishikimi i paketës së përgatitur tashmë prej më shumë se dy vjet, por për shkak se opozita nuk e ka miratuar dhe konfirmuar asnjëherë kalimin e asaj pakete në seancë ka krijuar vërtet një vështirësi në sistem, përtej faktit të kësaj mungese dhe këtij vakumi ligjor, ashtu siç e ka kryer ministri i Drejtësisë rolin e tij në kuadër të hetimeve apo verifikimeve paraprake në këtë procedurë tranzitore për gjyqtarët, ashtu do të duhej ta kryente edhe Prokurori i Përgjithshëm për prokurorët. Kjo do të thotë se të gjithë jemi në mungesë kompetencash apo në mungesë të një kuadri të qartë ligjor për inspektimet apo hetimet disiplinore. Nga ana tjetër, nuk mund të lëmë gjyqtarët dhe prokurorët të kryejnë shkelje, që kanë të bëjnë jo thjesht me disiplinën apo çështje të një karakteri të parëndësishëm, por që cenojnë edhe besimin e publikut.

Jam e bindur se të gjithë i keni ndjekur lëvizjet apo veprimet e Ministrisë së Drejtësisë në rastet kur nga verifikimi paraprak kemi evidentuar edhe vendime të padrejta të gjyqtarëve, duke ia çuar Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektoratit ekzistues, pavarësisht një mungese kompetence, që të gjendet një zgjidhje për të kryer gjithë procedurën hetimore dhe disiplinore për këta gjyqtarë. Do të duhet i njëjti proaktivitet, mbase edhe pak me tejkalim kompetence, për të hetuar disiplinarisht prokurorët që kanë shkelur ligjin. Ky është mendimi im.

Për sa u përket sistemeve të menaxhimit të çështjeve, kanë të bëjnë me ndryshimin e Kodit Penal të vitit 2017. Për këtë arsye, ne e kemi ngritur në mënyrë të vazhdueshme si shqetësim. Së fundi i është bërë edhe një shkresë Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ministrisë së Financave i është kërkuar nevoja e përmirësimit të programit dhe sistemit të menaxhimit të çështjeve, si dhe mirëmbajtja teknike e specializuar e këtij sistemi. Kjo deri në momentin kur do të fillojë funksionimi dhe çështja e menaxhimit më të mirë apo e menaxhimit nga dy këshillat e rinj për sistemet që kanë prokuroritë apo gjykatat.

Për sa i përket pyetjes për hetimet proaktive, ashtu siç e tha edhe zonja Bushka, një ndër rekomandimet është pikërisht rritja e numrit të tyre, pra rritja e ndjekjes së rasteve kryesisht. Prokurori ka detyrimin ligjor, që, kur shikon dhe vihet në dijeni për një vepër penale apo për elemente që cenojnë një marrëdhënie, që kanë të bëjnë me një vepër penale, ta fillojë çështjen. Krahësuar me numrin total, kjo është një shifër shumë e vogël.

Pavarësisht se ne sot kemi një sistem të decentralizuar, ku prokurori i çështjes është zot i çështjes së tij, përsëri Prokurori i Përgjithshëm ka si detyrë, edhe në këtë suazë të re ligjore dhe kushtetuese përgjegjësisë, të drejtojë drejtuesit e prokurorive dhe prokurorët për rekomandimet dhe prioritetet për vendin, sidomos për çështje që kanë të bëjnë me krimin e organizuar apo korrupsionin. Kjo është edhe arsyeja që këto rekomandime i drejtohen Prokurorit të Përgjithshëm, se nëse do të ishte që Prokurori i Përgjithshëm nuk do të kishte asnjë rol, do të duhej t'i drejtohej çdo prokurori të Republikës së Shqipërisë. Por meqenëse Prokurori i Përgjithshëm ka për detyrë edhe për të drejtuar politikat e ndjekjes penale, të hetimeve, mënyrën sesi do të zhvillohen ato, është pikërisht Prokurori i Përgjithshëm që ka për detyrë për t'u dhënë drejtuesve apo prokurorëve rekomandimet e qeverisë, ashtu siç ka ndodhur. Nëse e marrim që prokurori i çështjes është zot i çështjes së tij, ka të bëjë me aspektin e përmbajtjes dhe vendimit, por hetimet proaktive janë të një karakteri tjetër.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Kush e do fjalën?

Në fillim, nënkryetari, zoti Lita. Zoti Qefalia, sipas Rregullores një këtej dhe një andej.

Korab Lita – Faleminderit, zoti kryetar!

Zonja Ministre, ndryshimet kushtetuese dhe paketa e re ligjore në sistemin e drejtësisë kompetencën e kontrollit mbi prokurorinë ia kanë kaluar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Deri në krijimin e këtij institucioni në dispozitat e fundit tranzitore të ligjit nr. 96 të vitit 2016 këtë

kompetencë ia ka lënë Prokurorit të Përgjithshëm nëpërmjet inspektorëve të tij. Kam një pyetje : a është ngritur ndonjë strukturë pranë Prokurorit të Përgjithshëm që përmbush këtë vakancë ligjore apo dispozitat kalimtare?

Ju thoni se në kuadër të rekomandimeve të vitit 2018 për zbatimin e kuadrit të ri ligjor, në funksion të garantimit të procesit ligjor për viktimat e veprës penale, Prokuroria e Përgjithshme ka miratuar shtesa në numrin e punonjësve, në strukturën e prokurorisë për vitin 2019. Ka caktuar me organikë koordinatorë, psikologë të viktimave në të gjitha prokuroritë. A keni një informacion se sa eficiente ka qenë kjo shtesë organike? Pasi keni analizuar informacionin nga IEVP-ja e Kavajës lidhur me kohëzgjatjen e paraburgimeve të të miturve thoni se këto informacione ia keni përcjellë KLP-së, KLGJ-së dhe prokurorive. A keni një informacion më të detajuar për gjendjen dhe trajtimin e të miturve në IEVP- të e të gjithë Shqipërisë? E kam fjalën për standardet e trajtimit të tyre në funksion të standardeve të BE-së.

Shikojmë se gjatë hetimeve të çështjeve nga prokuroria në disa raste rezultatet e veprimeve proaktive pa përfunduar hetimi dalin në medie. A keni marrë ndonjë masë lidhur me nxjerrjen në medie të rezultateve të veprimeve proaktive? Desha edhe opinionin tuaj.

E fundit, u njohëm me raportin dhe rekomandimet e bëra për prokurorinë nga Këshilli i Ministrave në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar apo veprave të rënda penale. Besoj se jeni njohur me ngarkesën e punës së një prokurori dhe vakancat që ka krijuar vetingu në sistemin e prokurorisë. A ka sjellë kjo një ngarkesë në punën e prokurorëve, si rrjedhojë a ka sjellë ulje të eficiencës së punës apo të cilësisë së punës së tyre?

Ulsi Manja - Shumë faleminderit, zoti Lita!

Zonja Ministre, do t'ju lutesha që për shkak të dinamikës së madhe që kam, po shikoj se të gjithë kolegët kanë kërkuar të bëjnë pyetje, përgjigjet të jenë në mënyrë sa më të përmbledhur dhe koncize, për efekt kohe e kam fjalën.

Etilda Gjonaj- Për sa i përket strukturës së posaçme për hetimet disiplinore është ngritur në fillim të vitit 2018 menjëherë me ardhjen e Prokurores së Përgjithshme, e cila e ngriti si strukturë pikërisht për hetimet disiplinore.

Për sa u përket shtesave organike, që përmendët, kjo është bërë për të gjitha prokuroritë dhe është në buxhetin e vitit 2019. Sapo ka filluar efekti dhe ende nuk kemi një matje të efektivitetit të organikës së shtuar në prokurori.

Lidhur me ngarkesën që mund të kenë prokurorët edhe në momentin që disa prej tyre mund të jenë larguar nga procesi i vetingut, pavarësisht se ky i fundit ende nuk ka shkuar të prokurorët e rretheve gjyqësore apo të prokurorët e thjeshtë të apeleve, jo drejtuesve, me qëllim që të evidentojmë këtë ngarkesë. Gjithsesi kërkon në mënyrë të vazhdueshme një mirëadministrim të ngarkesës së çdo prokurori.

Për pyetjen që lidhet me çështjen e sekretit hetimor, mund t'ju them se nuk është ministri i Drejtësisë që merr masa për nxjerrjen e sekretit hetimor. Nxjerra e sekretit hetimor është vepër penale dhe në momentin që nxirret publikisht dosja, një dokument që janë pjesë e sekretit hetimor, ajo përbën vepër penale dhe duhet të fillojë procedimi penal. Me sa di unë, në 1-2 raste kur këto sekrete hetimore janë bërë publike është regjistruar vepra penale për nxjerrjen e sekretit hetimor.

Ndërsa për sa i përket gjendje së të miturve në Kavajë, është e vërtetë që kemi bërë një studim në kuadër edhe të zbatimit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit, për të parë masat që kërkohen nga prokuroria, por edhe dënimet që jepen nga gjykata për të miturit për vepra të ndryshme penale, ky raport i është bërë me dije KLGJ-së dhe KLP-së, ashtu siç edhe ju përmendët, por njëkohësisht edhe institucioneve të tjera të sistemit të drejtësisë.

Aktualisht, të miturit janë vetëm në institutin e veçantë të Kavajës, nuk ka të mitur të tjerë në institucionet e tjera të paraburgimit apo burgjeve. 4 janë të dënuar dhe rreth 32 janë të mitur të paraburgosur.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Ministre!

Urdhëroni, zoti Qefalia!

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Ministre!

Ishit shumë shteruese në diskutimin tuaj, madje edhe në materialin që keni paraqitur.

Unë do të kisha interes t'ju pyesja për një nga vlerësimet që keni bërë edhe ju si ministri, të cilat i keni evidentuar si probleme, madje këto probleme janë ravijëzuar edhe nga ndërkombëtarët. Një ndër problemet kryesore është mosevidentimi i saktë i të dhënave dhe unifikimi i të dhënave statistikore. Ky është problemi i parë.

Problemi i dytë, që e kanë evidentuar edhe ndërkombëtarët dhe e keni vënë edhe ju ndër vlerësimet e punës, është monitorimi i bërë për mosndëshkueshmërisë së zyrtarëve, gjyqtarëve, politikanëve dhe personave, të cilët paraqesin interesa të fuqishme biznesi.

Ndërkohë, një problem tjetër i papërmbyshur në rekomandimet e bëra prokurorisë është edhe moscuria dhe mosfinalizimi i hetimeve financiare.

I përmenda të gjitha këto për të pasur gjykimin dhe opinionin tuaj, se cilat janë arsyet e mospërmbyshjes së këtyre rekomandimeve.

Mos ka lidhje me procesin e zgjatur të vetingut?

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Qefalia!

Urdhëroni, zonja Ministre!

Etilda Gjona – Në respekt të pyetjeve tuaja, pavarësisht se Ministria e Drejtësisë bën vlerësimin e saj për zbatimin e rekomandimeve, përcakton atë që është realizuar apo jo dhe ku do të duhet të shkojmë më tej, nuk mundet të analizojë arsyet pse janë këto rezultate. Kjo për shkak se është e pamundur dhe nuk është në kompetencën e Ministrisë së Drejtësisë për të analizuar arsyet e moszbatimit të rekomandimeve. Duhet të jetë Prokuroria e Përgjithshme që do të japë argumentet në raportimin e tyre dhe të tregojnë se cilat janë arsyet.

Gjithsesi, personalisht, nuk mendoj se është procesi i vetingut ai që po ndikon në mosrealizimin e këtyre rekomandimeve kryesore që lidhen me procesin, kryesisht me korrupsionin dhe krimin e organizuar, sepse ka një ndjeshmëri shumë të lartë, ndërkohë janë prioritete.

Nga ana tjetër, unë mendoj se organizimi edhe në këtë periudhë transitore i prokurorisë mbase ka bërë që të ketë një vonesë apo një zvarritje të procesit. Ajo çka është rekomanduar në mënyrë të vazhdueshme është që KLP-ja dhe Prokuroria e Përgjithshme dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë në momentin që do të ngrihet, do të duhet të ketë në vëmendje pikërisht zvarritjet e proceseve hetimore, zgjatjen e afateve të hetimit pa arsye apo çështjet të tjera që lidhen pikërisht me kërkesën për konfiskimin apo sekuestrim të aseteve që vinë nga veprimtaria kriminale.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Ministre!

Urdhëroni, zonja Mara!

Aurora Mara – Faleminderit, zonja Ministre!

Unë kam vetëm një pyetje për një çështje me ndjeshmëri të lartë për publikun. Për ngritjen e institucioneve të reja të drejtësisë, mekanizmave që do të ndëshkojnë zyrtarët e lartë të përfshirë në çështje korruptive (një hap shumë i rëndësishëm që do të ndihmojë në rifitimin e besimit të publikut ndaj organeve të drejtësisë), a është llogaritur tashmë një kohë maksimale e realizimit të këtyre organeve, siç është, për shembull SPAK-u?

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit!

Etilda Gjonaj – Duke qenë se ministri i Drejtësisë, në kuadër të strategjisë ndërsektorale të drejtësisë, është koordinatori dhe ai që mbikëqyr, monitoron zbatimin e reformës në drejtësi, nga informacioni që kemi marrë nga KLP-ja për krijimin e SPAK-ut, prokurorisë së posaçme, janë në fazën e verifikimit dhe vlerësimit të kandidatëve, ku mendohet se ky proces do të përfundojë deri në fund të majit. Më pas, pasi edhe procedura e brendshme KLP-së të ketë përfunduar për verifikimin e këtyre kandidatëve, do të duhet të presim procesin e vetingut për secilin kandidat të prokurorisë së posaçme.

Procesi i vetingut është një proces, për të cilin nuk mund të themi se kemi një afat, do të ngrihet si prioritet kryesor edhe me operacionin ndërkombëtar të monitorimit, ku të kenë një listë prioritare të kandidatëve që janë për prokurorinë e posaçme. Por është e vështirë të thuash një datë të përcaktuar për procesin e vetingut të këtyre kandidatëve.

Ajo çka është e rëndësishme është prioritet për procesin e rivlerësimit kalimtar, vetingut, të jetë për kandidatët që janë për prokurorinë e posaçme dhe Gjykatën Kushtetuese, meqenëse janë institucione që pritet të ngrihen shumë shpejt.

Gjithsesi, Këshilli i Lartë i Prokurorisë është në procesin e kryerjes së të gjitha procedurave, që duhen ndjekur lidhur me vlerësimin dhe verifikimin e kandidatëve për SPAK-un, dhe them se ky proces do të përfundojë shumë shpejt.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Ministre!

Zoti Përmeti.

Andi Përmeti – Zonja Ministre, një fjali përpara se të bëj tri pyetjet që kam. Ne si ligjvënës, kemi nevojë edhe për opinionet tuaja, si ekzekutiv që jeni, për të kuptuar se si t'i zbatojmë më mirë ligjet dhe si t'i përmirësojmë ato. Kësisoj, në pyetjen time të parë kërkoj nga ju një opinion direkt, si ministre drejtësie. Dy pyetjet e tjera janë konkrete, në lidhje me pikat këtu. Pyetja e parë ka të bëjë me garantimin e pavarësisë së prokurorëve. Sigurisht, rekomandimi primar është garantimi i pavarësisë së prokurorëve nga Prokuroria e Përgjithshme. Mua si ligjvënës, por jam i bindur se edhe njerëzve që na dëgjojnë, na shqetëson më shumë fakti se si mund ta garantojmë, ju kryesisht, pavarësinë e Prokurorit të Përgjithshëm, rrjedhimisht edhe të prokurorëve të tjerë, nga qeveria. Çfarë opinionit dhe çfarë këshillash na jepni neve si ligjvënës, që egërsia e prokurorisë – mbase dhe me të drejtë, se unë jam jurist, kështu që nuk po e gjykoj këtë pjesë – ndaj dikujt që kapet me 30 mijë lekë drita apo ndaj dikujt që vë një tullë para shtëpisë së tij, të jetë e

barasvlershme me hetimin dhe procedimin ndaj kryetarëve të bashkive që kapen me përgjime, ndaj ish-ministrave që kapen me afera prej miliona eurosh e të tjera.

Në lidhje me këtë, do të doja një opinion nga ju. Si ta distancojmë garantimin, dhe si ta kemi sa më të pavarur Prokurorinë e Përgjithshme nga vetë qeveria dhe ndikimi i tyre për këto dosje që janë shumë shumë herë më të mëdha.

Tani dy pyetjet e tjera, të cilat janë konkrete.

Ju dëgjova me vëmendje kur folët në lidhje me luftën kundër korrupsionit. Ju cituat se ne kemi bërë hapa përpara në luftën kundër korrupsionit, sidomos kundër trafikimit të lëndëve narkotike. Nuk mund të them nëse jam apo s'jam dakord, por dua ta kem të qartë unë, por dhe të gjithë të tjerët që dëgjojnë, metodologjinë e këtij vlerësimi, që do të thotë: ky vlerësim është bërë duke u krahasuar me gjashtë vjet përpara, apo është bërë duke u krahasuar me një vit para? Sepse po të jetë duke u krahasuar me një vit para, sigurisht që vetëm përmirësim do të ketë, sepse më keq se aq s'kishte ku të shkonte. Pra, dua metodologjinë tuaj të krahasimit.

Pika e tretë, e cila ka të bëjë me të drejtat e njeriut, në dijeninë time – ju mund të më korrigjoni nëse jam i gabuar, sepse unë e kam informacion – burgjet janë me 23 % mbipopullim. Në qoftë se është e vërtetë, cila është zgjidhja për uljen e këtij mbipopullimi, gjë që është shumë e rëndësishme sa u takon të drejtave të njeriut.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Përmeti!

Zonja Ministre!

Etilda Gjonaj – Për sa i përket garantimit të pavarësisë së prokurorisë, çdo prokurori apo Prokurorisë së Përgjithshme, tashmë e kemi zgjidhur këtë histori. Prandaj dizenuam gjithë kuadrin e ndryshimeve kushtetuese e ligjore, të gjithë paketën ligjore për reformën e re në drejtësi. Kjo do të thotë se çdo prokuror është i pavarur në hetimin që kryen. Drejtuesi i prokurorisë, ashtu sikundër e dini, nuk zgjidhet as nga qeveria e as nga Prokurori i Përgjithshëm.

Ashtu siç e dini, me sistemin e ri një prokuror nuk zgjidhet, nuk emërohet, nuk promovohet, nuk shkarkohet më nga Prokurori i Përgjithshëm, sepse është Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Po ashtu, jeni në dijeni se tashmë, se Prokurori i Përgjithshëm nuk zgjidhet më thjesht nga Kuvendi, me shumicë të cilësuar, por Kuvendit i shkojnë tre kandidatët më të mirë, pasi janë vlerësuar e verifikuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i cili është një organ kolegjal.

Pra, të gjithë mekanizmat e ngritur nga reforma në drejtësi garantojnë pikërisht pavarësinë e të gjitha hetimeve ose pavarësinë e mënyrës se si promovohen, emërohen e shkarkohen prokurorët në sistem. Ashtu si edhe gjyqtarët.

Lidhur me mbipopullimin e burgjeve, informacionin e keni të gabuar. Unë e dhashë dje në interpelancë, dhe jam e bindur se po të kishit qenë pak kuriozë dhe të kujdesshëm për të dëgjuar fjalën time në interpelancë, do ta kishit dëgjuar që thashë: shënon një përmirësim apo një shifër historike, pasi sot mbipopullimi është 0 %.

Lidhur me...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta mbaroj, të lutem!

Ulsi Manja – Të lutem, le të përfundojë ministrja me përgjigjet e pyetjeve.

Etilda Gjonaj – Lidhur me konstatimin tuaj, se si monitorohet veprimtaria e Prokurorisë së Përgjithshme apo e të gjithë organit të prokurorisë... Thashë: “konstatim” që në fillim, për arsye se thatë disa shifra apo disa konkluzione të gabuara për sa i përket rasteve që unë përmenda lidhur me veprat penale në fushën e lëndëve narkotike, drogave e të tjera.

Për sa i përket metodologjisë, pyetjes që ju bëtë, statistikën, mënyrën se si Ministria e Drejtësisë e kryen procedurën, Ministria e Drejtësisë mbështetet nga dy informacione periodike që merr nga Prokuroria e Përgjithshme një herë në gjashtë muaj, ku përfshihen edhe statistikën.

Gjithashtu, janë jo vetëm statistikën që ofron Prokuroria e Përgjithshme, por njëkohësisht kemi edhe sektorë statistikash në Ministrinë e Drejtësisë, ku bëhet krahasimi me vite. Po ashtu, janë edhe konstatimet e katër ministrive të linjës, që lidhen me zbatimin e rekomandimeve që duhet të ndiqen nga prokuroria. Njëkohësisht, u referohemi të gjitha monitorimeve, raporteve e sugjerimeve të organizmave ndërkombëtarë.

Kjo është metodologjia, sipas së cilës kryhet pikërisht monitorimi për zbatimin e rekomandimeve.

Sot që flasim është procedurë që të bëhet një krahasim me vitin paraardhës për të kuptuar se si ka shkuar trendi. Nuk është kërkesë ligjore apo kërkesë e mëparshme e Komisionit të Ligjeve që ne duhet të bënim një krahasim 5-vjeçar, 10-vjeçar, apo 3-vjeçar, përkundrazi, gjithmonë raportimi ka qenë vetëm për vitin aktual, por për të sjellë një vlerë të shtuar në këtë raportim ne bëme krahasim edhe me vitin 2017 dhe kjo është arsyeja.

Ulsi Manja- Fjalën e ka zonja Xhina.

Elena Xhina – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj ministren për parashtrimin dhe raportin e paraqitur!

Zonja Ministre, në vlerësimin tuaj, rekomandimet e dhëna nga Këshilli i Ministrave a përputhen me prioritetet e vendosura nga vetë organi i prokurorisë dhe objektivat e saj?

Pyetja e dytë. Në luftën kundër korrupsionit, në faqen 11 të raportit, ju konstatoni si problematikë se bashkëpunimi i prokurorisë me institucionet e tjera ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndëshkimin penal has disa problematika, por pa i specifikuar ato. A mund të na i përmbledhni me pak fjalë se cilat janë këto problematika dhe a është parashtruar një zgjidhje për këto?

Faleminderit!

Etilda Gjonaj – Lidhur me faktin nëse rekomandimet që qeveria shqiptare i jep Prokurorisë së Përgjithshme përputhen me prioritetet dhe objektivat e saj, dua t’ju them se rekomandimet e Këshillit të Ministrave janë të detyrueshme për Prokurorinë e Përgjithshme. Kjo do të thotë se Prokuroria e Përgjithshme bën më pas drejtimet, duke shtuar edhe elemente të tjera që ka evidentuar nga puna apo edhe nga rezoluta që do të lërë Kuvendi lidhur me veprimtarinë e Prokurorit të Përgjithshëm, të cilat i ka të detyrueshme për zbatim. Linjat fillojnë pikërisht nga prioritetet që ka qeveria për luftën kundër korrupsionit, kundër krimit të organizuar apo kundër kriminalitetit duke zgjedhur disa nga rekomandimet më kryesore. Në momentin që ministri i Drejtësisë harton rekomandimet, që më pas ia paraqet për konsultë të gjitha ministrave apo Këshillit të Ministrave për miratim, e bën këtë proces pasi ka marrë të gjitha mendimet, sugjerimet dhe rekomandimet e aktorëve, por duke mbajtur në konsideratë edhe vlerësimin e analizës që ka bërë për sa u përket rezultateve të luftës kundër kriminalitetit. Pra, është një proces i tërë, që vjen nga një analizë përpara se këto rekomandime të miratohen dhe t’i adresohen Prokurorit të Përgjithshëm.

Lidhur me problematikat si lufta kundër korrupsionit apo marrëdhëniet me autoritetet e huaja, janë disa problematika. Unë nuk u ndala, sepse raporti është shumë i zgjeruar dhe i plotë, por ajo që ne kemi rekomanduar është pikërisht bashkëpunimi midis programit të prokurorisë dhe institucioneve të tjera ligjzbatuese, duke kërkuar një forcim të mëtejshëm të këtij bashkëpunimi, sidomos në drejtim të përfshirjeve të tyre në hetime, rasteve të referuara prej tyre dhe për vepra penale, të cilat ata janë më të specializuar apo veprimeve proaktive në kuadër të forcimit të kapaciteteve profesionale dhe trajnimeve të përbashkëta të oficerëve të Policisë Gjyqësore. Këtu

flasim për agjencitë ligjzbatuese vendase, sepse ato me karakter ndërkombëtar unë i përmenda në pikën 5, për sa u përket rekomandimeve drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm.

Ulsi Manja- Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Zeneli, pastaj fjalën e ka zoti Braho.

Alban Zeneli – Faleminderit, zoti kryetar!

Në opinionin tim, ky raport i lexuar nga ministrja e Drejtësisë ishte totalisht i panevojshëm për komisionin tonë, sepse edhe në raport-informacionin që sapo dëgjuam është cilësuar që ministri i Drejtësisë nuk e kontrollon më ligjshmërinë e veprimtarisë së prokurorëve. Meqenëse koha është shumë e rëndësishme edhe për ne, edhe për ministren, unë kam një pyetje lidhur me përgjegjësinë që ka direkt. Në raportin tuaj ju thoni që një problematikë e veçantë është paraqitur nga Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm për sistemin e burgjeve dhe, konkretisht, keni referimet e paraqitura prej saj në prokuroritë e rretheve gjyqësore, nga të cilat për 20 çështje është vendosur mosfillimi i procedimit penal, 6 janë pushuar, 8 çështje janë pezulluar.

Zonja Ministre, a mund të na thoni, meqenëse jeni drejtuese e këtij institucioni, cila është arsyeja e këtyre referimeve, a është paaftësia e këtyre që kanë referuar apo ndonjë arsye tjetër?

Faleminderit!

Etilda Gjonaj – Zoti kryetar, nëse më lejoni, dua të lexoj përsëri nenin që citova, i cili lidhet me detyrimin që ministrja e Drejtësie ka për të raportuar në komision, por njëkohësisht edhe për rekomandimet që i drejton Prokurorit të Përgjithshëm. Neni 103 pika 5, thotë: “Këshilli i Ministrave, nëpërmjet ministrit të Drejtësisë, ndjek në vazhdimësi mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të dhëna prej tij”. Pika 1 e këtij nenin thotë: “Këshilli i Ministrave, jo më vonë se data 31 mars, miraton dhe i përcjell Prokurorit të Përgjithshëm rekomandimet prioritare që duhen ndjekur për vitin në vazhdim në luftën kundër kriminalitetit dhe rekomandimet duhet të përmbajnë informacion për ndryshimet e buxhetit, që janë të nevojshme për realizimin e tyre. Domethënë, kjo është një kompetencë direkte dhe ky është ligji nr. 97/2016 i paketës për reformën në drejtësi.

Për sa i përket asaj që iu referuat, në të vërtetë edhe unë e kam shqetësim që rastet, të referojmë në prokurori, ose pushohen, ose vendoset mosfillimi i tyre apo nuk ka një ndjekje që të kemi mundësinë të marrim rezultate. Nuk besoj se kjo lidhet me arsyet e veprimtarisë së Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve. Gjithsesi, detyra ime është që të ndjekim të gjitha hallkat gjyqësore dhe të ankimit, më pas është pikërisht sistemi gjyqësor ai, i cili vendos në fund.

Ulsi Manja – A ka pyetje tjetër?

Urdhëroni, zoti Zeneli!

Alban Zeneli - Zonja Ministre, që të jemi më konkretë, të gjitha procedimet janë po kaq: 20, 6 dhe 6? Domethënë, të gjitha procedimet, referuar Drejtorisë së Burgjeve, janë pushuar?!

Ulsi Manja – Po, edhe mund të ketë shkuar ndonjë në gjyq.

Etilda Gjonaj - Unë nuk jam përgatitur për të raportuar për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve, por, gjithsesi, ky është një rezultat, që është përfshirë në raportin e zbatimit të rekomandimeve të vitit 2018. Pikërisht nga numri total, që u është dërguar prokurorive të rretheve, për 20 çështje është vendosur mosfillimi dhe për 6 çështje është vendosur pushimi. Por kjo nuk do të thotë se kaq është numri total. Numri total, me aq sa unë mbaj mend se e nxora dje për interpelancën, pasi nuk i kam me vete shifrat, nga janari 2018 deri në prill të vitit 2019 kanë qenë 555 raste të referuara në prokurori.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Ministre!

Fjalën e ka zoti Braho për pyetje, më pas fjalën e ka zoti Alimadhi.

Spartak Braho – Edhe unë ndaj të njëjtin mendim lidhur me raportin, ndonëse nuk do ta konsideroja tërësisht shterues. Raporti e prek të gjithë problematikën, por 23 faqe janë shumë, aq më tepër që ka kakofoni në rekomandimet e Këshillit të Ministrave për prokurorinë, apo tuajat për prokurorinë. Kështu që duhet parë, pra të redaktohet, për të qenë më i saktë.

Së dyti, dua të jap një opinion që lidhet me prokurorinë. Nga leximi i materialit, kuptohet, dhe në njëfarë mase është objektive, që prokuroria nuk është në eficiencë të plotë të punës së saj. Kjo del edhe nga materiali. Nuk do të përmend përqindje, është 50% në eficiencë apo 80%, por prokuroria po kalon një fazë riorganizimi, e cila, pa dyshim, do të reflektojë edhe në veprimtarinë e saj.

Së fundi, duhet të kemi parasysh se në të gjithë veprimtarinë e organeve ligjzbatuese, por posaçërisht për prokurorinë, për gjykatën për juve finalja është dënimi, masat e dënimit dhe lidhet me një faktor të rëndësishëm, pra që preket lehtas në material, me politikën e dënimit. Ajo që unë mendoj ta shtroj si pyetje është: si ndiqet konkretisht politika e dënimit? Konkretisht, si e ndjek Ministria e Drejtësisë? A ka vendime unifikuese, orientime, sepse njëri i bie gozhdës tjetri patkoit, jo vetëm në prokurori, por edhe në organet e gjykatës. Ky është shqetësim dhe relativisht ministria duhet të jetë e shqetësuar, sepse për këtë është i shqetësuar opinione dhe shteti: si zbatohet politika e dënimit?

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Braho!

Urdhëroni, zonja Ministre!

Etilda Gjonaj – Ministria e Drejtësisë për mënyrën se si ndjek politikën e dënimit, dhe shpeshherë kërkon dhe bën rekomandime drejtuar institucioneve dhe sistemit të drejtësisë duke përfshirë këtu edhe Këshillin e Lartë Gjyqësor, mbështetet te statistikën që mbledh një herë në vit, dhe te ditari statistikor. Gjithashtu, e bën këtë edhe nëpërmjet analizave të ndryshme në lidhje me çështje të ndryshme, pra sipas tematikës. Por, duke pasur në konsideratë edhe shqetësimin tuaj, zoti Braho, ka edhe një çështje tjetër, që në këtë periudhë ne si Ministri e Drejtësisë, e shikojmë me vështirësi. Për sa kohë që institucionet janë të reja, presim ende institucione të tjera të sistemit që të ngrihen, pa dyshim do kohën e saj derisa çdo gjë të vihet në vendin e vet.

Ashtu siç e thatë edhe ju, politika e dënimit është një ndër shqetësimet kryesore jo vetëm të shtetit, por edhe të opinionit publik. Këtë po mundohemi ta vëmë në vijë nëpërmjet statistikave dhe analizave, sapo institucionet e reja të sistemit të drejtësisë të ngrihen. Gjithsesi, është një çështje që do ta kemi në konsideratë edhe duke diskutuar në tryezat që ne bëjmë me institucionet e reja.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Ministre!

Po, zoti Braho.

Spartak Braho – Ne e kemi përcaktuar me ligj që prokurori i çështjes është i pavarur dhe ne jemi të detyruar ta zbatojmë. Unë kam shqetësim që kjo pavarësi është relative dhe duhet të jetë relative. Do t'ia dëgjojmë muzikën historisë së prokurorit plotësisht të pavarur më vonë. Ndoshta do ta vërtetojë koha nëse është bërë mirë apo keq ky ndryshim.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Braho!

E ka kërkuar fjalën për pyetje zoti Alimadhi. Më pas zonja Hoti.

Adriatik Alimadhi – Faleminderit, zoti kryetar!

Përderisa Ministria e Drejtësisë është pjesë e ekzekutivit, kuptohet që edhe materiali trajtohet më shumë politikisht sesa është realitet. Unë dua të pyes ministren për statistikën e prokurorisë, e cila ka konstatuar një numër gati 40 000 çështje. A ka një statistikë të qartë për ndarjen e krimeve se nga vijnë? Pra, vijnë nga problemet e pronave apo drejtime të tjera, që ne si ligjvënës, në fund të fundit, të marrim një nismë ligjore?

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Alimadhi!

Po, zonja Ministre.

Etilda Gjonaj – Të gjitha të dhënat që marrim nga prokuroria, të kryqëzuara me ato që vijnë nga gjykata, janë statistika që dalin në vjetarin statistikor, ku për çdo vepër penale, që parashikon Kosi Penal, jepen shifra specifike. Prandaj, të gjitha këto statistika që ju kërkon do të dalin në vjetarin statistikor për vitin 2018, i cili është duke përfunduar.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Ministre!

Po, zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Ideja ime është se opinioni publik duhet ta dijë nga burojnë këto krime. Pra, ne si ligjvënës duhet të mendojmë pak për t'i paraqitur institucionit më të lartë, ligjvënësit në këtë rast, problematikat nga vijnë krimet. Pra, besoj se Ministria e Drejtësisë duhet të ketë një statistikë. Nëse nuk e kemi, ne si Komision i Ligjeve vazhdojmë kot.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Alimadhi!

Ministrja sapo tha se shumë shpejt do të kemi një vjetar statistikor për të gjithë dinamikën e veprave penale të ndodhura në vitin 2018. Gjithsesi, shqetësimi juaj është shumë i drejtë.

Adriatik Alimadhi – Mua më shqetëson shifra e lartë. Pra, janë gati 40 mijë krime të referuara në një vit. Pra, ne si ligjvënës a nuk duhet të kemi një statistikë se nga vijnë këto krime?

Ulsi Manja – Patjetër që duhet ta kemi. Sot kemi ministren e Drejtësisë këtu, kurse javën tjetër do të kemi prokuroren e Përgjithshme, për të na treguar dinamikën e kriminalitetit. 40 mijë vepra penale të raportuara janë shumë, por gjithsesi do të jetë pjesë e raportimit.

Etilda Gjonaj – Unë mund të jap shifra të veprave penale që lidhen me rekomandimet e qeverisë drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2018.

Për sa u përket statistikave, ashtu siç e thatë edhe ju, nuk është detyrë e ministrit të Drejtësisë të raportojë në Komisionin e Ligjeve, por nëse do t'ju nevojitet një raport specifik për çdo vepër penale se sa janë statistikat, padyshim që do të përgatitet nga ne dhe do t'ju dërgohet.

Ulsi Manja – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, zoti Zeneli, sepse e ka kërkuar zonja Hoti më parë fjalën për pyetje.

Besoj se këtu do t'i mbyllim pyetjet sepse, 100% e deputetëve të pranishëm kanë bërë pyetje.

Zonja Hoti, fjala është për ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Bode ka mbajtur shënime.

Po, zonja Hoti.

Elda Hoti – Zonja Ministre, për sa i përket drejtësisë për të miturit, në funksion të garantimit të procesit të rregullt ligjor, në rekomandimin e Këshillit të Ministrave parashikohet zbatimi i aplikimit të masave alternative të shmangies nga ndjekja penale. Çfarë masash konkrete alternative janë parashikuar që të vihen në zbatim, sepse duke mos u kujdesur për rehabilitimin e këtyre të miturve ne kontribuojmë në rritjen e kriminalitetit? A keni raste të identifikuara që policia ka ushtruar dhunë ndaj të miturve nën moshën 18 vjeç në protestë?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hoti.

Po, zonja Ministre.

Etilda Gjonaj – Besoj se pyetja e dytë nuk është për ministrin e Drejtësisë dhe nuk besoj se ka nevojë për koment. Çdo zyrtar i lartë që vihet në dijeni për një fakt apo indicie, që përbën vepër penale, ka detyrimin ta kallëzojë në prokurori.

Për sa i përket çështjes së të miturve, është kërkuar nga Ministria e Drejtësisë me këtë shkresë drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme apo të gjitha institucioneve të drejtësisë, pikërisht zbatimi i të gjitha alternativave të dënimit që përmban Kodi i Drejtësisë për të Miturit, me qëllimin që arresti me burg apo dënimi me burg të jetë masë ekstreme për të miturit.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Ministre!

Nuk besoj se ka pyetje të tjera. Është një seancë dëgjimore që ka zgjatur 2 orë dhe e ka marrë të gjithë kohën e nevojshme. Kemi gati 2 orë që po bëjmë këtë seancë dëgjimore me ministrin e Drejtësisë. Nëse është e mundur, me mirëkuptimin e kolegëve, dua të them disa konsiderata të mijat, në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Ligjeve, për raportimin e ministrit të Drejtësisë mbi mënyrën e zbatimit nga prokuroria të rekomandimeve prioritare të dhëna nga KM-ja në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2018. Në parantezë, dua ta falënderoj ministrin e Drejtësisë për raportin objektiv (siç e cilësuan disa nga kolegët), të paraqitur në Komisionin e Ligjeve, por edhe përgjigjet që u dha shqetësimeve dhe problematikave të ngritura nga kolegët deputetë.

Në fakt, sistemi i drejtësisë është një sistem transformimi i plotë edhe për shkak të reformës në drejtësi dhe, siç u theksua edhe këtu, ka përfunduar kuadri i plotë ligjor në kuadër të zbatimit të reformës në sistemin e drejtësisë, por nuk është ngritur ende e gjithë arkitektura e institucioneve të reja të drejtësisë për shkak të kësaj reforme. Këtu e kam fjalën për një institucion

shumë të rëndësishëm që është Inspektori i Lartë i Drejtësisë e, që këtu u evidentua si problematikë mungesa e kapaciteteve inspektuese. Kur flitet për mungesë të kapaciteteve inspektuese, të gjitha institucionet, që punojnë me ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve, që kapitulli që ka të bëjë me masat disiplinore është shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese, që është një çështje shumë e rëndësishme që lidhet me ligjin.

Nga ana tjetër, kemi mungesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në këtë kuptim si Prokuroria e Përgjithshme apo agjencitë e tjera ligjzbatuese (këtu e kam fjalën për inspektimin që ka të bëjë me gjyqësorin), kanë punuar me kompetenca të limituara.

Ajo që duhet të sjell në vëmendjen e kolegëve të komisionit, por edhe të opinionit publik, është reforma e thellë që ka pësuar sistemi i drejtësisë penale në Shqipëri dhe posaçërisht, organi i prokurorisë. Filozofia e gjithë reformës në sistemin e drejtësisë penale, qoftë asaj kushtetuese, por edhe asaj ligjore dhe këtu kam parasysh ligjin për organizmin dhe funksionimin e prokurorisë, ligjin për SPAK-un dhe Kodin e Ri të Procedurës Penale, që është në fakt reforma e vërtetë në sistemin e drejtësisë penale, sepse deri tani jemi mjaftuar, duke thënë se sukcesi i reformës në drejtësi janë ndryshimet ligjore, por jo, një reformë tjetër shumë e rëndësishme është Kodi i Procedurës Penale. Cila ka qenë filozofia? Prokurori lider i hetimit. Prokurori i çështjes, lider i hetimit, pra pavarësi funksionale e prokurorit në ushtrimin e hetimit dhe të ndjekjes penale. Se sa do t'ia kemi dalë apo do t'ia dalim kësaj filozofie të ndryshimit të sistemit të drejtësisë penale, ju lutem se këtë e ngritit si shqetësim edhe kolegu Braho, kjo mbetet për t'u provuar. Jemi ende herët, sepse reforma e vërtetë në sistemin e drejtësisë penale sapo ka nisur nga zbatimi, për të arritur në konkluzione lidhur me këtë fakt.

Një shqetësim tjetër i komisionit, që duhet ta reflektojmë në të ardhmen, ka të bëjë me përmirësimin e metodologjisë së raportimit në komision të ministrit të Drejtësisë në lidhje me direktivat e qeverisë në luftën kundër kriminalitetit, e parë kjo në këndvështrimin e ligjeve të reja të reformës në sistemin e drejtësisë.

Për çfarë duhet të raportojë ministri i Drejtësisë këtu? Sigurisht, duhet të vijë të raportojë për ato direktiva që ka qeveria në luftën kundër kriminalitetit dhe në veçanti, korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Është shumë e rëndësishme të fokusohemi te politika e dënimit, sepse në finale ky është interesi i ekzekutivit, i qeverisë, që ka marrë përsipër të qeverisë dhe ka marrë votën e qytetarëve

për këtë. Cila është politika e dënimit në finale? Sa, si dhe ku agjencitë e zbatimit të ligjit i kanë realizuar detyrat që kanë të bëjnë me parandalimin dhe me ndëshkimin?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, se unë jam njeri politik!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, mos më ndërhyjni! E kam mbyllur komisionin. Mund të largoheni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, zoti Alimadhi! Unë jam njeri politik.

(Ndërhyrje pa mikrofon)..

Në qoftë se ti nuk e konsideron veten njeri politik, ky nuk është faji im.

Adriatik Alimadhi – Mbaruam?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem! Unë jam njeri politik. Nëse ju jeni teknik, është çështje tjetër.

Adriatik Alimadhi – Mirë pra!

Ulsi Manja – Unë jam njeri politik.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E përsëris, unë jam njeri politik.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, më lejoni të flas dhe mos më ndërprisni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Xhina!

Ju lutem, kolegë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Qefalia!

(Debat në sallë)

A do të më lejoni të flas?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem! Nëse shërbimet e Kuvendit nuk ju kanë sqaruar siç duhet për Rregulloren e Kuvendit, të nderuar kolegë, kjo nuk është imja, por juaja.

Adriatik Alimadhi – Ju kërkoj ndjesë!

Ulsi Manja – Ju kërkoj ndjesë?!

Edhe një herë, ju lutem, mos më ndërprisni kur flas, sepse unë vetë e kam detyrim ligjor, sipas Rregullores së Kuvendit, t'ju dëgjoj me vëmendje deri në fund! Madje, kur unë e marr fjalën, kjo Rregullore e Kuvendit, që shërbimet e Kuvendit, me sa duket, nuk e kanë transmetuar siç duhet te deputetët, krijon edhe këto problematika.

Ju lutem, mos më ndërprisni! E theksova këtë, për të dalë në konkluzionin që Prokurori i Përgjithshëm, me reformën e re në sistemin e drejtësisë penale, nuk është më lider i hetimit. Çfarë detyre ka sot Prokurori i Përgjithshëm? Merr direktivat e qeverisë në luftën kundër kriminalitetit dhe, nëpërmjet një udhëzimi me karakter të përgjithshëm, ka detyrimin ligjor t'i përcjellë poshtë te drejtuesit e prokurorive vendore dhe më pas te prokurorët e hetimit.

Ne duhet të gjejmë mekanizmin e duhur se si këto direktiva të qeverisë të shkojnë te prokurorët respektive që kanë në dorë hetimin. Nëse do të gjejmë mekanizmin e duhur për ta bërë sa më efektive këtë marrëdhënie: qeveri (nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë) – Prokuror i Përgjithshëm – drejtues të prokurorive dhe prokurorë të çështjeve, unë them që sukcesi në luftën kundër kriminalitetit, në veçanti ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar, do të jetë i garantuar.

Janë kostot e reformës këto që kemi deri tani. Pse janë kostot e reformës? Sepse është një periudhë kalimtare si për prokurorinë, ashtu edhe për gjyqësorin, pasi sapo kanë hyrë në fuqi dhe po zbatohen një pjesë e ligjeve, ndërkohë që është ende e papërfunduar arkitektura.

Kolegët, me të drejtë, kishin shqetësimin: si do të adresohen siç duhet çështjet e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, sidomos në radhët e zyrtarëve të lartë? Presim SPAK-un dhe Byronë Kombëtare të Hetimit. Ministria e tha: “Janë në proces”, por shpejtësia, me të cilën do të ngrihen këto institucione, varet nga zbatimi me sukses i procesit të vetingut.

Gjithashtu, u ngrit një shqetësim në lidhje me mbipopullimin e burgjeve. Ministria, në fushën e përgjegjësisë së të cilës është sistemi penitenciar, e tha: “Jo” dhe mua më vjen mirë që këtu u tha, madje u theksua me të drejtë që për herë të parë nuk kemi mbipopullim në burgje. Por, pse jo, do të duhet që të shkojmë drejt aplikimit të dënimeve alternative, që, edhe pse nuk kemi mbipopullim, e mira është të bjerë numri i të dënuarve edhe në burgje, pra të vijë duke rënë edhe më shumë popullimi në sistemin penitenciar.

Gjithsesi, shumë faleminderit të gjithë kolegëve, por për ta mbyllur, do të kërkoja nga relatorja dhe nga këshilltarët që problematikat e ngritura sot këtu të mbahen në konsideratë, në mënyrë që t'i bëjmë pjesë të rezolutës që ky komision do të miratojë për raportimin, pasi të raportojë Prokurori i Përgjithshëm në Komisionin e Ligjeve.

Ndërkohë, dua të ftoj edhe kolegët që, duke qenë se ministri i Drejtësisë raporton para Prokurorit të Përgjithshëm në Komisionin e Ligjeve, të gjitha këto problematika, një pjesë e të cilave kanë lidhje edhe me raportimin që do të bëjë Prokurorja e Përgjithshme, t'i mbajë në konsideratë që edhe aty, ku nuk është marrë përgjigjja e duhur, për shkak të natyrës së raportimit, t'i adresohen Prokurores së Përgjithshme.

Zonja Ministre, shumë faleminderit për prezencën sot në komision dhe për kohën në dispozicion!

Nga komisioni ynë bashkëpunimi institucional, si deri tani, mbetet i hapur.

Në fakt, komisioni ynë këta dy vjet ka pasur bashkëpunim të shkëlqyer me Ministrinë e Drejtësisë për sa i përket përmbylljes me sukses të drafteve të fundit të reformës në drejtësi dhe, natyrisht, kemi në proces disa ndryshime shumë të rëndësishme, që kanë të bëjnë përsëri me sistemin e drejtësisë penale (e kam fjalën këtu për paketën e ndryshimeve në Kodin Penal, për të cilën jemi në një proces bashkëpunimi të ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë), por, e përsëris, dyert e këtij komisioni janë të hapura për bashkëpunim konkret, gjithmonë në funksion të një objektiv të përbashkët, që është garantimi i atyre prioriteteve që qeveria ka në luftën kundër kriminalitetit.

Edhe një herë, shumë faleminderit të gjithë kolegëve, të pranishmëve dhe përfaqësuesve të medieve! Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA